



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më 19.12.2011, në orën 10.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyqi dhe Duda Balje.

Munguan: Justina Pula, Biserka Kostiq dhe Kymete Bajraktari.

Pjesëmarrës të tjerë: Visar Bivolaku-EUSR, Elita Vokshi- OSBE, Ukë Gashi- ZPRK, Nuredin Ibishi -Këshilltar i Kryetares së Komisionit nga CDF-i, Bujar Ukzmajli dhe Dardan Halili-Humanistica, Safet Berisha- Gazetar, Lejla Selimi- OSBE, Mimoza Jupa- Ambasada Amerikane, Irfan Kastrati- Avokati i Popullit, Basri Berisha- Institucioni i Avokatit të Popullit, Edita Doli - Radio-Dukagjini, Terina Zamper- OSBE, Natyra Kasumaj dhe Driton Selmanaj-KDI, Boguljub Staletoviq-Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Burim Tahiri- praktikant.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj- koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi Suazan Novoberdali, kryetare, e cila konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë

R e n d t ë d i t ë s:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 9 dhe 25 nëntor 2011,
3. Raporti i KDI- së për të gjeturat në lidhje me kompetencat e Komisionit,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për liritë fetare të Kosovës,

5. Shqyrtimi i kërkesës së Avokatit të Popullit lidhur me vështirësitë që po ballafaqohet ky institucion,
6 Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 9 dhe 25 nëntor 2011

Rita Hajzeraj- Pati vërejtje në procesverbalin e datës 9 nëntor, në pikën 4 të rendit të ditës, të hiqet fjalia „se nuk e shoh të arsyeshme shumë që kjo punë t’i besohet shoqërisë civile, sepse ata mund të kenë krejtësisht opinion tjetër nga Komisioni. Ajo tha se duhet të jetë „se kjo punë është më mirë të kryhet nga ana e deputetëve”. Komisioni e miratoi procesverbalin e datës 9.11.2011 me vërejtjet e deputetes Rita Hajzeraj, ndërsa procesverbali i datës 25.11.2011 pa vërejtje u miratua.

3. Raporti i KDI-së për të gjeturat në lidhje me kompetencat e Komisionit

Kryetarja- Lidhur me shkrimin në gazetën Zëri, të datës 13 dhjetor 2011, theksoi se **KDI** përveç të gjeturave të tjera cek se Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, kinse shqyrton peticione të cilat bien në kompetencë të gjyqësorit dhe cenon pavarësinë dhe integritetin e gjyqësorit.

Ajo e njoftoi Komisionin me raportin e KDI- së dhe kërkoi përfaqësuesit e saj të na sqarojnë se në çfarë baze kanë ardhur në këtë përfundim dhe se ka përzierje të kompetencave në mes Komisionit dhe gjyqësorit gjatë shqyrtimit të peticioneve. Ne, si Komision, kemi pasur konsideratë të jashtëzakonshme dhe gjatë shqyrtimit të kërkesave dhe peticioneve jemi munduar të mos e cenojmë pavarësinë e gjyqësorit, prandaj ftoj përfaqësuesit e KDI- së të na japin sqarime lidhur me raportin.

Driton Selmanaj, KDI- Tha se ne e kemi vlerësuar si ndërhyrje në punën e gjyqësorit këto tri raste: Rastin „Kiqina”, rastin e banorëve të fshatit Bellanicë dhe rastin e kërkesës së Kryqit të Kuq të Kosovës. Ne i kemi vlerësuar këto raste, sepse janë raste të cilat janë iniciuar në gjykatë, ose raste të cilat veç kanë marrë aktgjykimin e formës së prerë dhe assesi nuk duhet të jenë pjesë e shqyrtimit. Këto çështje i vlerësojmë se është shumë e qartë që duhet të ekzistojë balancimi i pushteteve në Kosovë dhe çfarë është pavarësia e tyre. Prandaj Komisioni s’ka të drejtë të nxjerrë vendime, por as shqyrtimi i tyre, kemi konsideruar se cenon punën e institucioneve të tjera që ekzistojnë në Kosovë. Për këtë arsye kemi ardhur në përfundim se Komisioni nuk duhet të trajtojë temat të cilat janë në shqyrtim në gjykata ose edhe kanë marrë interpretim nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Për këto raste kuvendi i Kosoves nuk ka të drejtë as t’i trajtojë ato çështje, në atë ditë kur ka pasur të trajtohet rasti Kiqina kemi përgatitur një reagim publik, mirëpo meqë është hequr nga rendi i ditës, nuk e kemi bërë reagimin, por kemi konsideruar se Kuvendi i Kosovës po shndërrohet në një institucion, i cili definitivisht prek pavarësinë e gjyqësorit. Kjo ka qenë ideja pse ne e kemi hedhur këtë në raport.

Kryetarja- Tha se sa i përket rastit Kiqina, ju e dini ligjin për nisma legislative dhe me 10 mijë nënshkrime është e drejta të procedohet një çështje në Kuvend. Rasti Kiqina është trajtuar në Komision, sepse i ka pasur më shumë se 10 mijë nënshkrime, ka shkuar për Kryesi, jo me vota unanime, por me shumicë votash. Mirëpo nuk kemi pasur ndonjë vendim lidhur me çështjen, por vetëm për diskutim, përfundime konkluzione nuk ka pasur, është dërguar në kryesi nga Komisioni i ynë, që aty të shqyrtohet dhe të vlerësohet edhe njëherë se a të qitet në seancë për debat apo jo? Kështu ka qenë procedura për rastin Kiqina.

Ndërsa sa i përket rastit të fshatit Bellanicë i kemi ftuar përfaqësuesit e AKP-së që ta sqarojnë rastin dhe i kemi njoftuar ata se kurrësi interesi i ynë nuk është që të përziemi në punën e gjyqësorit. Në procesverbalin e datës 25 nëntor është komplet fjalimi dhe mendimi se si e kam thënë lidhur me rastin e Bellanicës, nëse dikujt i intereson se çka kem vendosur lidhur me rastin, qëllimi ka qenë vetëm t'ua lehtësojmë punën se si ata të marrin përgjigjet e duhura, sepse e dini shumë mirë që nuk merren parasysh dhe e kanë parë të vetmen zgjidhje që të adresohen në Komision. Dihet që përgjigjeje mund të marrin përmes dhomës së veçantë të Gjykatës Supreme.

Sa i përket kërkesës së Kryqit të Kuq të Kosovës dihet se kompanitë e sigurimeve me ligj janë të obliguara të kontribuojnë me 1%. Ata ju kanë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, e kanë marrë përgjigjen që duhet të respektohet ligji, nuk ka çështje gjyqësore këtu, ndihmesa e jonë këtu ka qenë se ata nuk e kanë proceduar rastin në gjyq. Ne vetëm kemi dalë me atë se BQK duhet t'i njoftojë kompanitë private se duhet të respektohet Ligji për Kryqin e Kuq të Kosovës. Ne jemi shumë të hapur si Komision. Kur e kam lexuar më 13 dhjetor këtë raport jam befasuar, sepse mbledhjet tona kanë qenë gjithmonë të hapura dhe transparente.

Driton Selmanaj- Tha se mund të ndodh që ne i kemi vlerësuar këto raste gabimisht, por ne mendojmë që kemi të drejtë, nëse konsiderohet se është shkelur një e drejtë, është vetëm Gjykata Kushtetuese, ajo që i trajton ato raste dhe assesit nuk është punë e Komisionit. Pra nuk duhet trajtuar rastet që janë në shqyrtim në gjykata ose edhe kanë marrë formën e prerë në gjykatë. Ju, si Komision, jeni ata që vendosni se a duhet pranuar një petition për shqyrtim apo jo, sepse kjo mund të kalohet në precedent për Kuvendin e Kosovës edhe për rastet e tjera dhe mund të vijë në pikëpyetje kredibiliteti i këtij institucioni.

Rita Hajzeraj- Tha se sa i përket rastit Kiqina kjo çështje ka qenë edhe në mandatin e kaluar dhe Komisioni atëherë kishte marrë vendim që për këtë çështje të bëhet debat në parlament. Në Kuvend çfarëdo çështje me qenë ka të drejtë përmes petitionit të ngrihet nga qytetarët. Ne, si Komision, kemi munduar ta kthejmë si petition, por dihet që Kryesia e Kuvendit është organi më i lartë dhe kompetent që i përcakton edhe pikat e rendit të ditës edhe seancat plenare, pavarësisht se si i rekomandojmë ne, si Komision parlamentar. Kur ka ardhur rasti Kiqina kemi pasur një vendim të Komisionit të kaluar. E dini se në atë kohë është ndërprerë puna e Kuvendit dhe ka mbetur pa u realizua ky debat. Kur ka ardhur i njëjti petition, me të njëjtat kërkesa, d.m.th. veç debat në parlament ata nuk kanë dashur të sqarohet, a ka qenë i drejtë apo jo? Ne vetëm e kemi trajtuar anën formale se si petition a i plotëson kriteret të kalojë deri në Kryesi të Kuvendit. Kryesia e

Kuvendit është organi politik në Kuvend që vendos, a bën të trajtohet një çështje apo jo, pse Kryesia e Kuvendit e ka kaluar?

Driton Selmanaj- Tha se cili do të ishte qëndrimi hipotetik në çfarëdo rastesh, ç' kishte mundur të përfundojë Kuvendi atë ditë, nëse kishte debat lidhur me këtë rast?

Kryetarja- Nuk ka pasur të merret vendim aty, sepse nuk ka pasur kërkesë për atë, e as për të nxjerrë përfundim, por vetëm ka pasur të bëhet debat parlamentar.

Albana Gashi- Tha se nëse ne, si Komision, nuk kemi të drejtë t'i shqyrtojmë këto peticione, atëherë nuk po e kuptoj pse ato vinë në adresë të Komisionit tonë, pasi ekziston Komisioni për Legjislacion.

Driton Selmanaj- Tha se kompetencat e Komisionit dhe fushëveprimtaria janë të përcaktuara me rregullore.

Rita Hajzeraj- Tha se sa i përket rastit të Bellanicës kërkesat e tyre i kanë plotësuar kushtet formale- juridike për t'u trajtuar si petition. Këta kanë konsideruar se u është shkelur e drejta e tyre, pse nuk i ka marrë parasysh as gjykata, as AKP-ja, nuk kanë as vendim të formës së prerë, as nuk ju kanë drejtuar asnjëherë dhomës së posaçme të Gjykatës Supreme. Kanë ardhur këtu sepse kanë menduar se u janë shkelur të drejtat dhe ne u jemi përgjigjur se nuk kemi të drejtë të merremi me këtë çështje. E vetmja e drejtë e jona është t'u japim ndihmë, ta thërrasim drejtorin e Kadastarit, përfaqësuesin e AKP- së dhe përfaqësuesit e fshatit për t'i ballafaquar dhe njoftuar me çështjen. Dihet shumë mirë që këta nuk kanë pasur mundësi të takohen dhe e vetmja mundësi ka qenë përmes Kuvendit të Kosovës-Komisionit.

Kurtan Kajtazi- Tha se petitionet janë raste më të rënda, ndoshta Komisioni parlamentar është shpresa e fundit që ata qytetarë e shohin dhe drejtohen këtu. Gjatë shqyrtimit të këtyre peticioneve mendoj se Komisioni ka qenë shumë transparent dhe pavarësisht se si e ka interpretuar KDI-ja apo edhe dikush tjetër, ne për këto i kemi procesverbalet- vendimet dhe dihet se çfarë qëndrime ka pasur. Te rasti Kiqina i kemi 50 mijë nënshkrime dhe Kryesia e Kuvendit e ka dërguar te ne, për ta trajtuar se a i plotëson kushtet si petition? Ne kemi thënë se si petition i plotëson kushtet për debat parlamentar. Ne i kemi dërguar në kryesi që Kryesia e Kuvendit ta trajtojë se a mund të hyjë në rend të ditës në seancë për debat apo jo? Prandaj nuk ka qenë e drejtë të akuzohemi për këtë çështje, sepse këtu nuk ka ndërhyrje në gjyqësor. Ndërsa sa i përket rastit Bellanica u tha edhe nga parafolëset e mija sepse ata njerëz nuk i ka marrë parasysh askush. Kjo nuk është çështje që duhet ta trajtojmë ne. Mirëpo ne atyre se paku ju kemi hapur një rrugë, si Komision parlamentar. Ata ende nuk kanë hapur ankesë në dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme që është kompetente për trajtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me AKP. Ne i kemi takuar ata qytetarë, i kemi takuar me përfaqësuesit e AKP- së dhe unë mendoj se kemi vepruar shumë drejtë. Ata tash e kanë një rrugë të hapur, sepse nuk e kanë ditur se ku të drejtohen, sepse askush nuk i ka udhëzuar se duhet të bëjnë ankesë në Dhomën e posaçme. Në asnjë rast nuk e kemi atakuar punën e gjyqësorit. Ne, si Komision, kemi të drejtë ta shqyrtojmë shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Ndërsa për rastin Kryqit të

Kuq, Gjykata Kushtetuese e ka kthyer vendimin në favor të zbatimit të ligjit dhe të Kryqit të Kuq të Kosovës. Mendoj se edhe ju dhe gjithkush është për atë që Kryqi i Kuq i Kosovës me qenë sa me i fuqishëm dhe me i fituar të drejtat që i ka me ligj.

Driton Selmanaj- Tha se është problemi te përmbajtja, por është çështje parimore dhe kategori kushtetuese, e ndarjes së pushteteve. Vlerësimi i ynë është se nëse ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese, më nuk ka punë kuvendi, dhe ne kemi vlerësuar kështu, se nëse fillohet me precedente të tilla nuk është praktikë e mirë. Nëse diskutohet me orë të tëra në Kuvendin e Kosovës, për rastin Kiqina dhe nuk dilet me një përfundim, nuk është punë e kuvendit të diskutohet dhe të mos nxjerrë një përfundim, një mocion, rezolutë ose edhe një deklaratë. Nuk është Kuvendi që duhet t'i rehabilitojë rastet. Kuvendi duhet ta ketë pushtetin e vet dhe ekziston ligji për ndihmë juridike, që mund të shkojnë qytetarët të marrin këshilla juridike. Prandaj nuk është Komisioni ai që duhet me dhënë këshilla juridike.

Kryetarja- Tha se sa i përket rastit Kiqina vendimi i ynë nuk ka qenë unanim, por ka kaluar me shumicë votash. Sidoqoftë rekomandimi në Kryesi ka shkuar si qëndrim i Komisionit. Prandaj edhe Kryesisë ju kemi drejtuar që ata ta vlerësojnë se duhet ose jo të bëjnë debat për këtë rast. Tash pse e ka qitur Kryesia në debat nuk është përgjegjësi e Komisionit. Mirëpo kjo ka shkuar pa kurrfarë konkluzioni, ka pasur kërkesë të bëhet një grup hetimor, të bëhen monitorime të ligjeve për këtë rast, por ju e keni qëndrimin tuaj, ne e kemi qëndrimin tonë dhe absolutisht nuk mendojmë si ju.

Albana Gashi- Njëra prej kërkesave në Komision ka qenë monitorimi i ligjit. Këtu nuk ka qenë qëllim të ndërhyjmë te vendimet që ka pasur t'i marrë gjykata, por Kuvendi e ka për detyrë t'i mbikëqyre ligjet që zbatohen edhe nga gjykata dhe pse bëhet monitorimi nuk do të thotë se ka ndërhyrje.

Përfundim

Komisioni unanimisht vendosi të demantojë raportin e KDI- së, sa i përket Komisionit për të Drejtat e Njeriut. Ky komision asnjëherë s'ka ndërhyrë në kompetencat e gjyqësorit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për liritë fetare të Kosovës

Kryetarja- Tha se ne kemi bërë monitorimin e ligjit për liritë fetare në Kosovë. Tani ky projektligj ende nuk është shqyrtuar në leximin e parë në Kuvend, është praktikë që si Komision Funkcional paraprakisht ta shqyrtojmë dhe të japim rekomandim, se si të veprohet. Ne e kemi analizuar projektligjin dhe mendojmë se projektligji i plotëson kushtet për miratim në leximin e parë në Kuvend.

Përfundim

Komisioni unanimitasht vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për liritë fetare në Kosovë.

6. Shqyrtimi i kërkesës së Avokatit të Popullit lidhur me vështirësitë që po ballafaqohet ky institucion

Suzan Novoberdaliu- Lidhur me kërkesë të institucionit të Avokatit të Popullit tha se këto ishin objekt shqyrtimi në agjendë të Komisionit. Komisioni nuk kishte marrë vendim lidhur me këtë, tani ne duhet të vendosim lidhur me këtë kërkesë. Në kërkesë ceket se ka nevojë për rritjen e bashkëpunëtorëve, ka mungesë të hapësirës, të mungesa buxhetore është cekur edhe çështja e imunitetit.

Basri Brisha, zëvendësavokat i Popullit – E njoftoi në pika të shkurtra Komisionin me problemet që ballafaqohet ky institucion. Nga të gjitha ato kërkesa, të cilat janë të cekura në kërkesë vetëm çështja e hapësirës është zgjidhur, dhe kjo është zgjidhur duke marruar jo ndërtesë private, për të cilën paguajmë qira, për kërkesat e tjera nuk kemi zgjidhje, se problem tjetër është edhe paga.

Duda Balje- Tha se Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa e ka pasur në shqyrtim kërkesën e Avokatit të Popullit dhe se komisioni i ka konsideruar si kërkesa jo reale duke mos iu dhënë mbështetje.

Rita Hajzeraj- Lidhur me kërkesat e institucionit të Avokatit të Popullit janë shumë të drejta. Ky institucion nuk mund të jetë i pavarur kur Qeveria nuk ndan buxhet të mjaftueshëm, nuk i krijon kushte për punë funksionale. Ne, si Komision, mund të bëjmë një rekomandim për Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe ata mund ta mbajnë një mbledhje urgjente për institucionin e Avokatit të Popullit. Nëse ata se marrin për bazë këtë rekomandim, ne, si deputetë dhe unë personalisht do ta ngrehi në seancë plenare.

Kurtan Kajtazi- Theksoi se do është mirë që këtij institucioni t'i krijohen kushte dhe hapësirë më e mirë për punë. Ne mund të kërkojmë nga Kuvendi të lejojë buxhet për t'i punësuar tre ose katër punëtorë në administratë, aty ku ka nevojë si në IT.

Rekomandim

Komisioni i rekomandon Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta rishqyrtojë mundësinë buxhetore lidhur me kërkesën e Institucionit të Avokatit të Popullit. Dhe vendosi që kërkesën e Avokatit të Popullit t'ia përcjellë Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, me lutje që ta rishqyrtojë kërkesën e Avokatit të Popullit dhe ta njoftojë me vendimin e marr.

7. Të ndryshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati debat.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdaliu